



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Nr. 116 Prot

Tiranë, më 06.11.2019

V E N D I M

Nr. 116 datë 06.11.2019

*“Për unifikimin e trajtimit të rasteve të dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit kalimtar sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar, gjate fazës së hetimit administrativ nga Trupat Vlerësuese të KJV”*

KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

Bazuar në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar, Kodin e Procedurave Administrative, Rregullores së Brendshme të KJV, nenit 6 dhe 8 të saj, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2019, pasi shqyrtoi çështjen lidhur me rastet e dorëheqjeve të subjekteve të vlerësimit në faza të ndryshme të hetimit administrative, për shkak të largimit nga detyra, me votë unanime të 15 anëtarëve të tij,

**V e n d o s i:**

1. Për të gjithë subjektet që janë pjesë e procesit të vlerësimit nga KJV, sipas nenit 6 dhe 13 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, të cilët gjatë fazës së hetimit administrativ kërkojnë ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar për shkak të dorëheqjes nga detyra në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës apo SHÇBA-së, cdo Trupë Vlerësimi e KJV, në momentin që njihet me kërkesën e subjektit, administron aktin e dorëheqjes nga detyra të subjektit si dhe aktin e lirimit nga detyra lëshuar nga Institucioni përgjegjës përkatës.
2. Trupa Vlerësimit, pasi verifikon aktin e lirimit nga Institucioni përgjegjës përkatës, deklarohet të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit pa një vendim përfundimtar, për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin kishte nisur procedura është bërë ligjërish i pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të neneve 94, pika 1, 2 dhe 95 të Kodit të Procedurës Administrative.
3. Trupa e Vlerësimit, për shkak të rrethanës së krijuar sipas pikës 2, vendos ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit sipas ligjit 12/2018, i ndryshuar, për shkak

të dorëheqjes së subjektit nga detyra, në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës apo SHÇBA-së, si dhe kërkesës së tij për ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar.

4. Trupa Vlerësimit, deklararon se subjekti ndodhet në të njëjtat kushte që parashikon neni 62 i ligjit 12/2018, i ndryshuar.
5. Në rastet kur dorëheqja e subjektit nga detyra, nuk pasohet edhe me kërkesën formale të subjektit për ndërprerjen e Procesit të Vlerësimit Kalimtar të nisur ndaj tij, Trupa e Vlerësimit komunikon me subjektin për të drejtën e tij për të paraqitur kërkesën për ndërprerjen e procesit të vlerësimit, në rast të kundërt, kjo Trupë vendos kryesisht për ndërprerjen e procesit në përputhje me nenet 4, 11 dhe 16 të Kodit të Procedurës Administrative.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI I JASHTËM I VLERËSIMIT

KRYETAR  
Ana Kapaj

